



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe**  
**Monitorimit**

Data	
Nr.	Prot.

**RELACION**

**PËR PROJEKTVENDIMIN**

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESVE PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR GJATË**  
**FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Neni 20, pika 1, shkronja “gj”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të miratuar projekt akte me karakter normativ për udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve.

Në zbatim të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe referuar vendimit nr. 15 datë 07.04.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore” është hartuar projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e një përmbledhjeje të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë financimin e fushatës zgjedhore për partitë politike/subjektet zgjedhore, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si dhe jep udhëzime për mënyrën e plotësimit të formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Projektvendimi nëpërmjet shembujve konkret pasqyron mënyrën e saktë të plotësimit të formularëve tip të raportimit financiar të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit si dhe afatet e dorëzimit.

Partitë politike/subjektet zgjedhore, të cilat marrin pjesë në zgjedhje, kandidatët dhe mbështetësit e tyre janë të detyruar të zbatojnë rregullat për financimin e fushatës zgjedhore.

Këta udhëzues synojnë të shpjegojnë aspektet kryesore të kuadrit ligjor dhe në veçanti të ndihmojnë partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit që garojnë në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore, për mënyrën e plotësimit të raporteve financiare të fushatës zgjedhore, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Në funksion të këtij qëllimi, janë përgatitur 4 (katër) udhëzues përkatësisht:

- 1-Udhëzues për raportimin e partive politike;
- 2-Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët e listave shumemërore;
- 3-Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetar bashkie;

4-Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Udhëzuesit janë të ndarë në dy pjesë kryesore:

- Pjesa e parë paraqet një pasqyrë të kuadrit ligjor që rregullon aspektet e financimit të fushatave zgjedhore.
- Pjesa e dytë ofron udhëzime për mënyrën e plotësimit të formateve të raportimit financiar.

Në pjesën e parë të udhëzuesve përfshihen përkufizime dhe shembuj konkretë të raportimit të financave në formatet standarde të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor. Në pjesën e dytë shpjegohet regjistrimi i veprimeve financiare në formatet e standardizuara dhe mënyra e duhur e raportimit të tyre.

Pjesë përbërëse e këtyre udhëzuesve janë të gjitha shpjegimet e nevojshme që kanë të bëjnë me seksionet kryesore të formatit tip të raportimit si më poshtë:

Për partinë politike:

1. Përmbledhje financiare
  - 2.a Të ardhura - Financime publike
  - 2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
  - 2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
  - 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike/subjekti zgjedhor - Financime jopublike
3. Huatë dhe Kreditë
4. Shpenzimet e partisë/subjektit
  - 5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore
  - 5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për organet e qeverisjes vendore
6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Për kandidatët e listave shumëemërore:

1. Përmbledhje financiare
  - 2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike

2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

2.c Huatë dhe Kreditë

3. Shpenzime

Për kandidatin për kryetar bashkie:

1. Përmbledhje financiare

2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike

2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

2.c Huatë dhe Kreditë

3. Shpenzime

4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit:

1. Përmbledhje financiare

2a. Të ardhura – financime publike

2b. Të ardhura nga dhurime monetare jo-publike (private)

2c. Të ardhura nga dhurime në natyrë jo-publike (private)

3. Kreditë dhe huatë

4. Shpenzime

5. Shpenzimet për mitingje në fushatë (pasqyrë)

Risi në këtë projektvendim janë:

- Në rast koalicioni kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie dorëzojnë raportet e tyre financiare tek kryefinancierit i partisë udhëheqëse të caktuar nga partitë politike përbërëse të koalicionit;

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

**Valbona BALLGJINI** - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

**Majlinda CELMETA** - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**Komisioni Rregullator**

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E UDHËZUESVE PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR GJATË  
FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si vijon:
  - a) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike/koalicionet, sipas modelit KQZ 07-06, shtojca n.r. 1 bashkëlidhur këtij vendimi,
  - b) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumemërore, sipas modelit KQZ 07-07, shtojca nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi,
  - c) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët për kryetar bashkie, sipas modelit KQZ 07-08, shtojca nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi,

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



“Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

- d) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, sipas modelit KQZ 07-09, shtojca nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij akti.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

<b>Iirjana</b>	<b>NANO -</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Arens</b>	<b>ÇELA -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dritan</b>	<b>ÇAKA -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Helga</b>	<b>VUKAJ -</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Muharrem</b>	<b>ÇAKAJ -</b>	<b>Anëtar</b>